



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



**MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015  
Nr. Dok. 201402365/2

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.Penale Tepelenë.*

**Drejtuar:** Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z. Artur Zoto

**TIRANË**

Drejtorit të I.E.V.Penale  
Z. Avni Sulaj

**TEPELENË**

**Të nderuar Zotërinj,**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Tepelenë me datë 10.11.2014. Në përbërje të grupit inspektues bënë pjesë Alfred Koçobashi, (jurist, drejtues i grupit inspektues), Irena Taga (juriste) dhe Alma Alibali (mjeke psikiatre), N/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, së bashku me ekspertët e shoqatës Përthyerje, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit të Institucionit të Avokatit të Popullit me eksperte të shoqërisë civile në kuadër të OPCAT-it .

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të dënuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

## ***Shënime paraprake***

Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit ekspertëve të grupit monitorues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin.

Në fillim të takimit ekspertët u takuan me drejtorin e institucionit Z. Avni Sulaj. Gjatë takimit, Drejtori parashtroi situatën në institucion duke evidentuar si problemin më kryesor në institucion mbipopullimin. Kapaciteti zyrtar i IEVP-së është 86 të paraburgosur dhe të dënuar, por gjatë vizitës në të kishte 160 persona, prej nga 32 të dënuar dhe 128 të paraburgosur. Në kategorinë e personave me probleme të shëndetit mendor ishin 4 persona, por për ta nuk kishte një ambient të veçantë trajtimi. Në kategoritë e tjera të veçanta ishin 8 persona 18-21 vjeçarë, 4 përdorues të lëndëve narkotike dhe 3 të alkoolizuar. Të punësuar në IEVP Tepelenë ishin 11 të dënuar.

Drejtori bëri me dije se në IEVP nuk ka pasur ngjarje të rënda. Masat disiplinore, kryesisht masa me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta, ishin përdorur për të dënuarit që kishin shkelur Rregulloren e institucionit. Këto masa ishin ekzekutuar në dhomat e tyre pasi ambientet e izolim/veçimit ishin kthyer në dhoma banimi duke e humbur kështu funksionin si ambiente për qëllim shlyerjen e masave disiplinore, kjo për shkak të mbipopullimit të institucionit.

Organika e të punësuarve në institucion ishte pjesërisht e plotësuar, pasi kishte mungesa të stafit mjekësor dhe një shkurtim të stafit psiko-edukativ. Këto mungesa në staf, në kushtet e mbipopullimit rezultojnë problematike.

Nga vizita pararendëse, në këtë institucion u konstatuan probleme në lidhje me mbipopullimin, infrastrukturën, higjienën personale dhe të përbashkët, etj.<sup>1</sup> Këto të meta të vërejtura nga monitorimi pararendës dhe masat e marra në lidhje me reduktimin apo përmirësimin e tyre ishin gjithashtu pjesë e diskutimit paraprak.

Në aspektin e infrastrukturës, institucioni i Tepelenës, u prezantua me një infrastrukturë tërësisht të amortizuar, pavarësisht përpjekjeve modeste nga ana e drejtuesit të institucionit për të adaptuar, riparuar apo përshtatur godinën ekzistuese në funksion të realizimit të qëllimit të saj në respekt të standardeve.

Aktivitetet dhe trajtimi edukativ në këtë institucion ishin të përpilueshme kjo si pasojë e mbipopullimit të skajshëm, mungesës së ambienteve dhe e bazës materiale të varfër për t'i zhvilluar ato.

### **1. Trajtimi**

---

<sup>1</sup> Shiko më gjatë përmbajtjen e raportit të monitorimit të grupit të ekspertëve të Avokatit të Popullit për institucionin e I.E.V.P.-së Tepelenë, 2013.

Në kuadër të monitorimit të drejtave të dënuarve/ paraburgosurve, grupi i monitorimit zhvilloi një vizitë monitoruese në ambientet e brendshme të institucionit, si dhe komunikoi në privatësi me të dënuarit/paraburgosurit. Gjatë takimeve private me vetë të dënuarit/ paraburgosurit dhe bisedave me to, grupi monitorues pyeti në lidhje me raste të ekzistencës së ushtrimit të dhunës fizike e psikologjike, apo shfaqjeve të sjelljes në mënyrë fyese ndaj tyre nga ana e punonjësve të institucionit. Në përgjithësi, prej të dënuarve/paraburgosurve ekspertët mësuan se ekzistonte një raport i mirë ndërmjet të dënuarve/paraburgosurve dhe punonjësve të institucionit.

Grupi monitorues mori informacione për ushtrim dhune dhe përdorim të tepruar të forcës nga ana e forcave të sigurisë së DAP-it. Një rast i tillë ekspertëve iu bë me dije nga i paraburgosuri K.T., i cili në muajin Shtator 2014 kishte qenë subjekt i përdorimit të tepruar të forcës, si dhe i ushtrimit të dhunës, duke u qëlluar me shkop gome dhe duke u mbajtur i lidhur edhe me pranga. Shkak për këtë ishte bërë një informacion (i cili rezultoi i pavërtetë) për ekzistencën e një celulari në dhomën e tij ku forcat e DAP-it ushtruan një kontroll të hollësishëm. Gjatë kontrollit i paraburgosuri K.T. ishte goditur më shkop gome, ishte prangosur dhe vendosur me fytyrë nga muri në ambientet e jashtme të qelisë deri sa kishte mbaruar kontrolli i hollësishëm në dhomën e tij. Mbas kontrollit, këtij të paraburgosuri i ishte bërë dhe presion psikologjik për të treguar se ku e kishte fshehur celularin. Gjithashtu dhe gjatë shoqërimit të tij në dhomë dhe pas heqjes së prangave i paraburgosuri K.T ishte vazhduar te goditej me shkop gome nga ana e forcave të DAP-it. Ky fakt, i cili u konfirmua dhe nga të paraburgosur të tjerë dëshmitarë okularë të ngjarjes në fjalë, iu referua drejtorit të IEVP Tepelenë duke i kujtuar se në të gjithë kohën është ai dhe vetëm ai përgjegjës për rregullin dhe sigurinë në institucion dhe se forcat e sigurisë së D.P.Burgjeve janë në mbështetje të operacioneve të sigurisë së përbashkëta në IEVP dhe duhet të koordinohen dhe monitorohen nga drejtuesit e institucionit.

Ankesat të tjera në lidhje me trajtimin i referoheshin kryesisht cilësisë së ushqimit, mbipopullimit në dhoma, mungesës apo cilësisë së dyshekëve, mungesës së medikamenteve dhe të shërbimit të stomatologjisë, si dhe orareve të reja të ajrimit që i privonin nga ajrimi gjatë pasdites. Një shqetësim tjetër që u ngrit gjatë intervistave ishte mungesa e ngrohjes dhe mosfunksionimi i kaldajave për periudhën e dimrit.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit u ankuan për mjediset e ajrimit, të cilat ishin të zbuluara pa tenda mbrojtëse nga reshjet apo dielli, dhe për vetë faktin se terreni në të cilin ndodhet ky institucion ofron klimë të ftohtë dhe të lagësht pothuajse për pjesën më të madhe të vitit, kryerja adekuate e ajrimit në të gjitha stinët ishte e pamundur.

Mjediset e përbashkëta ku duhej të ofroheshin aktivitetet arsimore, kurset e formimit profesional, aktivitetet për zhvillim të aftësive individuale, aktivitetet social-kulturore dhe asistencë shpirtërore mungonin krejtësisht. Kthimi i këtyre ambienteve në dhoma banimi kishte sjellë pengimin e zhvillimit të aktiviteteve integruese dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

## 2. Masat mbrojtëse.

Të paraburgosurit në institucionin e Tepelenës, të kategorive të rritur dhe të grup-moshave 18-21 vjeçar nuk ishin të ndarë në seksione. Për efekt të mbipopullimit në paraburgim, nuk ishte e mundur një ndarje e tillë në seksion të veçantë për grup-moshën 18-21 vjeçar, si rezultat dhe ajrimet dhe aktivitetet e përbashkëta grup-moshat 18-21 vjeç i zhvillonin jo të veçuar nga të paraburgosurit e tjerë të rritur.

Gjithashtu, në regjimin e brendshëm, kati i dytë, në një sektor, por me dhoma të ndara, banonin dhe të paraburgosur dhe të burgosur, të cilët aktivitetet i kryenin të veçuar nga njëri - tjetri.

Grupi i monitorimit u njoh me faktin se ambientet ku ekzekutohej masa e mbajtjes në veçim të përkohshëm, kryesisht masa me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta, janë kthyer në dhoma banimi duke e humbur kështu funksionin si ambiente për qëllim ekzekutimin e masave disiplinore.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve nuk u konstatuan parregullsi. Çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Lidhur me funksionimin e sistemit të ankesë/kërkesave të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë I EVP, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose dorazi. Ky i fundit i dërgonte këto ankesa në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte personalisht të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi.

Telefonat ishin në gjendje pune dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Pati ankesa për sa i përket telefonave për çmimin e lartë të impulseve.

Ambientet e takimeve me familjarët ishin të përbashkëta për të dy sektorët. Në dhomën e takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me xham dhe kangjella hekuri. Të paraburgosurit/dënuarit mund të takoheshin me familjarët e tyre një herë në javë. Nuk kishte një mjedis të veçantë ose dhomë për të paraburgosur që kanë fëmijë të vegjël. Një dhomë e vogël që gjendej në hyrje të godinës zakonisht përdoret për takime me të moshuarit, fëmijët dhe gratë shtatzëna, por në fakt nuk ofronte asnjë kusht për t'u konsideruar si ambient takimi, megjithëse kjo është e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së ambienteve shtesë.

Të gjitha kamerat e sigurisë në institucion ishin prishur si rezultat i një shkarkimi elektrik nga një rrufe dhe nuk funksiononin. Lidhur me këtë problematikë të rëndësishme, nga ana e Drejtorit të institucionit na u komunikua se ishte lajmëruar D.P. Burgjeve dhe një fond i veçantë ishte kërkuar për riparimin e shpejtë të sistemit të vëzhgimit me kamera.

### 3. Kushtet materiale

Në fokus të ekspertëve të grupit të monitorimit ishin edhe respektimi i standardeve normale të jetesës. U vizituan ambientet dhe u bisedua me të dënuarit/paraburgosurit mbi respektimin e këtyre standardeve, si dhe u vëzhgua në terren cilësia dhe respektimi i këtyre standardeve.

Sipas informacionit të marrë nga ana e të dënuarve/paraburgosurve kryesisht ata e kalonin pjesën më të madhe të kohës në dhoma. Kjo, edhe për arsye se sipas tyre, nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta në institucion. Dhomat ishin të pajisura me banja (nyje sanitare dhe me lavaman), si ndarje më vete, të cilat ishin pajisur së fundmi me dyer. Grupi i monitorimit vizitoi shumicën e dhomave të banimit.

Ndriçimi natyral ishte konform standardeve. Drita natyrale dhe ajrimi, sigurohej në dhoma përmes dritareve, të cilat ishin konform standardit të kërkuar.

Sipas informacionit të të dënuarve/paraburgosurve, këta të fundit furnizoheshin jo rregullisht nga ana e institucionit me produkte higjieno-sanitare, kryesisht me sapun, detergjent pastrimi dhe mjete për pastrimin e ambientit të përbashkët. Mungonte furnizimi nga ana e institucionit me produkte të domosdoshme për mbajtjen e një higjienë personale si: shampo flokësh, pastë e furçë dhëmbësh, të cilat, sipas të paraburgosurve, vinin nga familja ose kush kishte mundësi financiare i blinte pranë dyqanit të burgut.

Pati ankesa nga ana e të dënuarve/paraburgosurve edhe ndaj përmbushjeve të kërkesave të tyre personale për blerje, për shkakun që kishte të bënte me mosfunksionimin e mirë të vetë dyqanit dhe aplikimeve të çmimeve të larta në krahasim me tregun.

Grupi monitorues vizitoi ambientin e dusheve, i cili ishte i përbashkët. Nga tre poste për dushe, vetëm njëri prej tyre ishte funksional, dhe ky pa kokë dushi. Gjithashtu, grupi monitorues konstatoi edhe lidhje elektrike të ekspozuara dhe jashtë kushteve të sigurimit teknik në pajisjet e dushit. Gjithsesi dushet përdoreshin me grafik dy herë në javë. Sipas dëshmive të paraburgosurve këto dushe ishin të pamjaftueshëm për numrin e të dënuarve/paraburgosurve në institucion dhe zgjidhja e vetme e aplikuar ishte se ato lejoheshin të mbushin ujë të ngrohtë me kova për të bërë dush më pas në dhomat e tyre. Pavarësisht se grafiku i dushit (dy herë në javë) ishte konform kërkesave të ligjit, grupi i ekspertëve arriti në konkluzionin se praktikisht, me një dush në dispozicion të të gjithë katit të parë, ishte e pamundur të realizohej ai grafik.

Furnizimi me ujë dhe drita ishte i pandërprerë.

Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve monitorues u vu re se baza materiale ishte deri diku e plotësuar, por kishte edhe dhoma të cilat për shkak të mbipopullimit, nuk ofronin kushtet e nevojshme për jetesë. Në shumë prej dhomave, të paraburgosurit nuk kishin shtretër, por flinin me dyshek në

tokë. Konkretisht në dhomën nr. 24, me përmasa 4 m x 6 m afërsisht 24 m<sup>2</sup>, flinin 12 persona nga të cilët 4 persona flinin me dyshek në tokë. Dhoma 16 me përmasa 5m x 5m përafërsisht 25m<sup>2</sup> flinin 12 veta nga të cilët 4 veta flinin me dyshekë në tokë. Dhoma 14 me përmasa 2.50mx4m përafërsisht 10 m<sup>2</sup> flinin 5 veta nga të cilët 1 person flinte me dyshek në tokë. Shumica e dhomave ishin të këtyre dy përmasave dhe karakterizoheshin nga mbipopullimi, mungesa e hapësirës së banimit sipas standardeve, dhe persona që flinin me dyshek në tokë. Këto të dhënat lidhur me mbipopullimin e skajshëm në ambientet e I EVP Tepelenë përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria, ngrënë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.<sup>2</sup>

Kjo situatë e mbipopullimit në I EVP Tepelenë me përafërsisht 100% mbipopullim nga kapaciteti zyrtar, sjell shkeljen e një serë të drejtave të të burgosurve/paraburgosurve, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit jo vetëm që ka më pak hapësira jetike për çdo të burgosur, por ofrohen edhe më pak shërbime, të cilat në kushtet e një numri të paracaktuar stafi janë edhe më pak cilësore. Kësisoj, lëvizja në dhomë dhe ambiente të përbashkëta ishte e kufizuar si dhe kishte pakënaqësi lidhur me programet e edukimit dhe rehabilitimit të cilat në ato kushte mbipopullimi dhe përdorim të ambienteve dhe klasave si dhoma banimi ishin inekzistente.

Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitës në Shqipëri në vitin 1997 ka rekomanduar: *Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo më pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu dhe dhomat me të vogla se 6m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.*<sup>3</sup>

Gjatë vizitave në mjediset e korridoreve, dusheve të përbashkëta, dhomave u vu re një higjienë e munguar kryesisht për arsye të mungesës së detergjenteve personale dhe pajisjes me detergjent dhe klorizim të dusheve dhe tualeteve. Në shumicën e rasteve të gjitha detergjentet dhe pajisjet sanitare siguroheshin nga vete të paraburgosurit dhe të dënuarit.

---

<sup>2</sup> Një çështje e tillë është gjykuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës në rastin Sulejmanovic kundër Italisë. Gjykatësit e Strasburgut në vendimin e tyre kanë cilësuar se kufizimi i hapësirës jetike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve përtej standardeve ligjore të shteteve pale dhe ato të Konventave Ndërkombëtare përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Rasti i referohet një shtetasi të Bosnje-Hercegovinës i cili vuante dënimin në Burgun e Rebibbias në Itali i cili pretendonte se kishte qene subjekt i trajtimit jo human dhe degradues pasi kishte qëndruar për disa muaj së bashku me 5 bashkëvuajtës në një dhomë 16.20 m<sup>2</sup>. Gjykata e të Drejtave të Njeriut ka përdorur si parametra vlerësues rekomandimet dhe standardet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT). Në rastin e mësipërm, Gjykata e Strasburgut ka vlerësuar se situata e mbipopullimit në burgun e Rebibbias Itali ka qene evidente, dhe se vendosja e një personi në kushtet e një hapësire jetike prej 2.7 m<sup>2</sup>, larg standardeve minimale të CPT-së, përbën trajtim degradues dhe jo human dhe shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në përfundim të gjykimit nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut shteti Italian detyrohet të paguajë një shumë monetare ndaj të burgosurit Sulejmanovic për dëme morale dhe trajtim jo njerëzor dhe degradues.

<sup>3</sup> Albania: Visit 1997 [par.127]

Ushqimi shërbehej në 3 vakte, në orare të caktuara. Përgjithësisht pati ankesa nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve mbi cilësinë e ushqimit. U verifikua në terren kuzhina, e cila ishte në gjendje funksionale. Kuzhina ishte ri konstruktuar, por pajisjet e gazhinës nuk plotësonin standardet e një kuzhinë të gatimit të ushqimit social. Përsa i përket kërkesave në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, u konstatua se respektoheshin kërkesat ligjore. Ushqimi përgatitej sipas një liste të miratuar më parë dhe kampionet e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike. Por, në lidhje me sasinë dhe sidomos me cilësinë e ushqimit, u shfaqën shumë vërejtje nga ana e të dënuarve/paraburgosurve.

Për sa i përket larjes së teshave, në shumicën e rasteve vazhdonin të laheshin nga familjarët dhe akoma nuk kishte një lavanteri që të mund ta ofronte këtë shërbim, ndaj vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit mundësonin larjen e rrobave të fjetjes dhe atyre personale.

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social u vu re një bashkëpunim i mirë. Pengesë për kryerjen e punës nga stafi i edukimit ishte mungesa e ambienteve të përbashkëta dhe klasave gjë e cila kishte sjellë pengesa në zbatimin e punës nga ekspertët e edukimit. Në rastet kur kërkohej këshillim apo bashkëbisedim ai ofrohej në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin.

Grupi monitorues u informua për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe shqyrtoi me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve, dosje të 18-21 vjeçarëve, si edhe të personave me probleme të shëndetit mendor. Në dosjet nuk mungonin shënime lidhur me programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta me ta, megjithëse shumë prej tyre ishin formale sa për t'u shënuar, pasi mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe klasave për t'i zhvilluar ato i bënin të porealizueshme këto programe. Kryesisht pretendoheshin diskutime në grup për tema sociale dhe organizoheshin aktivitete sportive në ambientet e ajrimit. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Përsa i përket bibliotekës ajo mungonte dhe nuk kishte një ambient të veçantë për një funksion të tillë. Ato pak libra të trashëguara në institucion mbaheshin në ambientet e zyrave të institucionit dhe shpërndareshin sipas kërkesave të bëra nga vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit, por faktikisht gjatë intervistave me të burgosurit/paraburgosurit rezultoi se nuk ofroheshin libra leximi nga ana e institucionit, por vetëm nga familjarët.

Ajrimi është i vetmi aktivitet të cilin të paraburgosurit mund të kryenin së bashku për shkak të mungesës së hapësirave. Ajrimi në stinën e dimrit kryhej dy orë paradite. Institucioni ofronte dy ambiente ajrimi një ambient për kategori

të veçanta siç janë 18-21 vjeçarët, për personat me probleme të shëndetit mendor, si dhe për situata të veçanta në raste konfliktesh dhe mosmarrëveshjesh mes grupeve. Të dy katet e kryenin ajrimin të ndarë. Por në të dy fushat e ajrimit konstatohet situatë jo e mirë, pasi ambientet e ajrimit ishin plotësisht të zbuluar dhe nuk ofronin kushte për kryerjen e ajrimit në rastet kur moti është me shi, borë apo diell të nxehtë.

Për sa i përket punësimit në këtë I EVP punonin 11 të dënuar kryesisht si pastrues, sanitar, shpërndarës ushqimi etj. Nga intervistat e bëra me disa prej tyre rezultoi se nuk kishte probleme me dinamikën e punës.

## **5. Shërbimet shëndetësore**

Organika e shërbimit shëndetësor në këtë institucion ishte e përbërë nga një mjek me kohë të pjesshme, një ndihmës mjek-farmacist, katër ndihmës-mjekë dhe një stomatolog.

Gjatë vizitës së grupit monitorues, si dhe nga intervistat me të dënuarit u konstatuan problematika të ndryshme sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me prezencën e mjekut në regjim dhe me vonesat e theksuara në përgjigje të kërkesave të të dënuarve për vizita mjekësore në varësi të problematikave që manifestonin.

Gjithashtu, ankesa të shumta kishte edhe në lidhje me konsultat dhe ekzaminimet në qendrat spitalore në varësi të nevojave të dënuarve/paraburgosurve të cilët vuanin nga sëmundje kronike, ku rivlerësimet e gjendjes dhe të mjekimeve janë të domosdoshme.

Një tjetër problematikë e hasur në këtë institucion për sa i përket shërbimit shëndetësor ishin edhe mjekimet, të cilat në shumicën e rasteve mbuloheshin me ilaçe që silleshin nga familja.

Gjatë intervistave u vërejtën edhe shumë ankesa në drejtim të shërbimit stomatologjik, i cili mungonte, si për sa i përket mjekimeve ashtu dhe mbushjeve apo ekstraksioneve, madje megjithëse vizita e grupit inspektues zhvillohej brenda orarit zyrtar, stomatologu i institucionit nuk ishte prezent.

Institucionit nuk kishte një autoambulancë për shërbimet që duhej t'i ofrohej të dënuarve/paraburgosurve me konsulta, ekzaminime dhe analiza të specializuara në qendra spitalore.

Dhoma e infermierisë, e cila ndodhej brenda në regjim, ku bëheshin vizitat mjekësore, injeksionet apo perfuzionet sipas nevojave, ishte jashtë standardit, megjithëse e pajisur me një krevat vizitash, një tavolinë dhe tre stola, ato ishin të vjetra dhe tej mase të amortizuara. Aty ndodhej edhe një kuti ilaçesh që duhej të shërbente për medikamentet e urgjencës, e cila ishte bosh.

Dhoma e farmacisë ishte inekzistente në këtë institucion, për arsye se mungonte një ambient që mund të shërbente si e tillë. Të gjitha ilaçet



mbaheshin në dhomën e mjekut, jashtë regjimit, në zyrat e administratës, por nga grupi inspektues u konstatua një mangësi e theksuar e tyre, si për medikamentet e urgjencës, ashtu dhe për sëmundjet kronike.

Në dhomën e mjekut mbaheshin edhe kartelat mjekësore të kyçura me dry, por grupi i inspektimit nuk arriti të kishte akses në to, për shkak të mungesës së mjekut në institucion gjatë këtij inspektimi. Një problematikë tjetër ishte edhe fakti se në të gjithë dokumentacionin e mjekut, veçanërisht kartelat mjekësore, nuk kishte akses as ndihmës mjeku.

Dhoma e stomatologut nuk u verifikua nga grupi i inspektimit, meqenëse stomatologu nuk ishte në institucion dhe askush tjetër nuk kishte akses përveç tij në atë dhomë.

Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte fare në këtë institucion, për pasojë kishte dhe mangësi të theksuara në medikamente. Nga ana e stafit drejtues të institucionit u konfirmua se shumica e të dënuarve/paraburgosurve nuk ishin të pajisur me librezat shëndetësore. Ndaj dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte inefficente.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruar”.*

### **REKOMANDOJMË :**

1. Të merren masa të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Tepelenë me objektivin që çdo çeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
2. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të, Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 *“Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të*

*Paraburgosurve*", i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.

3. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik e kulturor në I.E.V.P. Tepelenë.
4. Të merren masa për përmirësimin e punës në sektorin e kujdesit social me qëllim që të mundësohet kryerja e këshillimeve dhe realizimi i temave sociale, si dhe që të mundësohet rritja e bashkëpunimit me institucionet, me qëllim rehabilitimin e të dënuarve/paraburgosurve.
5. Të merren masa për plotësimin e organikës me psikolog;
6. Të parashikohet një ambient i dedikuar për trajtimin psikoterapeutik të të dënuarve;
7. Të merren masa të menjëhershme për furnizimin e të paraburgosurve me produkte të domosdoshëm higjiëno-sanitare.
8. Të merren masat e nevojshme për riparimin dhe vënien në kapacitet të plotë të dusheve në institucion duke siguruar dhe parametrat e sigurimit teknik në lidhjet elektrike.
9. Të merren masat e nevojshme për ndarjen në sektor të veçantë të paraburgosurve të grup-moshës 18-21 vjeçar, për të evituar kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me të paraburgosurit madhorë.
10. Të merret në analizë dhe të raportohet pranë DPB rasti i ushtrimit të dhunës nga forcat e DAP-it në Shtator të 2014 ndaj të paraburgosurit K.T.
11. Të merren masa për parandalimin e ushtrimit të tepruar të forcës dhe përdorimin e mjeteve si shkopa gome apo pranga gjatë kontrolleve rutinë për sende të ndaluara në dhoma. Në këtë aspekt drejtorja e institucionit duhet të jetë me e vëmendshme dhe të marrë drejtimin e operacioneve të sigurisë në rastet e operacioneve të përbashkëta me forcat e DAP-it.
12. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor me një mjek me kohë të plotë.
13. Të merren masa të menjëhershme për kryerjen e vizitave të rregullta nga ana e mjekut të këtij institucioni, në mënyrë që të ofrohet një shërbim adekuat shëndetësor.

14. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.
15. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore.
16. Të merren masa të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve, në mënyrë që edhe furnizimi me ilaçe si për sëmundjet akute ashtu dhe ato kronike të kryhet sipas kësaj skeme.
17. Të merren masa të menjëhershme për sigurimin nga ana e drejtuesit të këtij institucioni e një fondi për medikamentet e urgjencës.
18. Të merren masa të menjëhershme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe konform standardeve të një dhome vizitash brenda në regjim.
19. Të merren masa të menjëhershme për ofrimin e një shërbimi të plotë stomatologjik me të gjitha ndërhyrjet e domosdoshme nga ana e stomatologut të institucionit.
20. Të merren masa të menjëhershme për riparimin e kamerave të sigurisë në institucion.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**